

FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

E ENJTE 13 TETOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot nga kjo foltore duhej të flisnim për emigrimin masiv, për rritjen e varfërisë, për rritjen e pasigurisë në vend dhe për largimin ditaditës nga standardet europiane dhe perëndimore. Duke nisur nga kjo e fundit, dua të risjell në vëmendjen e këtij parlamenti se punimet për projektin e autostradës Thumanë-Kashar po vazhdojnë teksa ne flasim, sepse qeveria nuk mund të presë Bashkimin Europian, por duhet të procedojë me koncesionin e radhës në agjendën e qeverisë.

Nuk jam kundër projektit që sjell zhvillim, prosperitet dhe ndërlidh qytetarët shqiptarë me njëri-tjetrin, por me duhet të theksoj se, para të gjitha këtyre, jam në krahun e qytetarit, por mbrojtjen e qytetarëve duhet t'ua garantojë qeveria, sepse ky është detyrimi ligjor i çdo qeverie. Teksa ne qëndrojmë këtu, banorët, të cilët preken nga shpronësimet, po mundohen të kuptojnë se çfarë do të ndodhë me fatin e pronës së tyre, sepse nuk ka pasur konsulta publike. Autostrada e re do të kalojë në zonat urbane dhe gjysmë-urbane të Thumanës, Fushë-Krujës, Rinasit dhe Vorës. Gjurma e kësaj rruge prek toka bujqësore, toka truall e mbi 30 shtëpi në Bashkinë e Krujës. Çdo të ndodhë me banesat që do të shemben? Çfarë do të ndodhë vallë me këto prona?

Shpronësimet janë kthyer në makthin e çdo shqiptari, sidomos kur dëgjon se çmimet për metër katror në vitin 2006 për ndërtimin e rrugës së Rinasit ishin më të larta se sot në vitin 2022 për një projekt të një rëndësie kombëtare. Pavarësisht se nuk kemi pasur prezantimin e një projekti të një rëndësie të tillë, ku do të na jepeshin informacionet që kërkojmë, nëse do t'i referohemi studimit të fizibilitetit për projektimin e rrugës Thumanë-Kashar. Faleminderit për seriozitetin, të nderuar ministra! E vlerësoj shumë faktin që vij këtu e mundohem të bëj një pasqyrë të

situatës, por nuk kam shumë nevojë të lodhem, sepse mund ta shikoni edhe vetë: të gjitha karriget e ministrave janë bosh.

Falënderojmë Kryetaren e seancës që nuk po e mbyll seancën, por, duke bërë detyrën tonë, do të vazhdojmë të jemi opozita që kemi qenë gjithmonë, të jemi në krahun e qytetarëve për të denoncuar dhe për të përcjellë shqetësimet e tyre në këtë parlament. Ashtu siç po thosha, pavarësisht se nuk kemi pasur një prezantim të një projekti të një rëndësie të tillë, ku duhej të na jepeshin informacionet që kërkojmë, nëse do t'i referohemi studimit të fizibilitetit për projektimin e rrugës Thumanë-Kashar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të vitit 2016, specifiku figura nr. 2, harta e vlerave për zonat kadastrale të prekura nga projekti, do të shikojmë se vlerat janë pothuajse të zhvlerësuar 10 herë më pak se vlera e tregut.

Kjo këtu është figura nr. 2 dhe ne mund të shikojmë se çmimet fillojnë nga 163 lekë deri në 448 lekë maksimumi për metër katror për tokë bujqësore. Siç mund të shikoni, këto janë çmimet e vetme referuese të publikuara në lidhje me shpronësimet dhe vijnë si vendim i qeverisë në vitin 2016 për hartën e vlerave, të cilat do të jenë për shpronësimin dhe ishin përcaktuar për 10 vjet. Çmimi në lekë për metër katror fillonte nga 163 lekë dhe maksimumi i saj është 448 lekë për tokën bujqësore.

Të nderuar kolegë, kjo është e papranueshme. Patjetër që duhet të ketë një rishikim të këtyre vlerave! Herën e fundit diskutova për ngritjen e një komisioni, i cili duhej të ketë autoritetin dhe ekspertizën e nevojshme, ku të vlerësohen pronat në vlerën reale, në vlerën e tregut! Çmimi i tregut është dhe duhet të jetë gjithmonë standard kushtetues i Republikës sonë, por sot ne përballemi me fakte të tjera. Kam disa pyetje. A do të rehabilitohen siç duhet sistemet vaditëse dhe të kullimit në këto zona? A do të kenë mundësi përdorimi për diferencën e tokës bujqësore, që u mbetet banorëve pas ndërtimit të autostradës? A do të ketë mbikalime ose nënkalime, të cilat duhet të ndërlidhin fshatrat përkatës, si në rastin e fshatit Bilaj në Bubq?

Si do ta kalojnë këta banorë rrugën, e cila parashikohet të kalojë në këto zona? Këto janë pyetjet që qytetarët më shtrojnë gjatë takimeve me ta. Duhej t'i kishin informacionet për këto pyetje, por nuk i kanë, sepse mbase është jashtë perceptimit të kësaj qeverie ideja se mbrojtja e interesat të qytetarëve është parësore, është e detyrueshme dhe është detyrë e gjithsecilit

prej nesh të luftojë për të drejtën, për mbrojtjen e qytetarit shqiptar dhe të mos lejojë që të cenohet prona private dhe dinjiteti njerëzor. Qeveria duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar që nuk do të ketë abuzime dhe të rishikohet patjetër kërkesa e qytetarëve për shpronësime në vlerën e tregut; duhet të bëhet çdo hap që ky proces të mos rezultojë në një tjetër konfrontim të qytetarëve me qeverinë për padrejtësinë.

Një projekt i kësaj qeverie jo vetëm kombëtar, por edhe rajonal, duhet shoqëruar me vullnet, duhet shoqëruar me transparencë dhe dinjitet nga kjo qeveri. Janë raste si këto që po i detyrojnë shqiptarët të braktisin vendin e tyre dhe të mos e kthejnë më kokën mbrapa. Shpresoj të ketë paktën një rivlerësim, por falënderoj të gjithë kabinetin e ministrave për vëmendjen! Faleminderit!